MONITORIMI
I BATERIVE

EZSELECT™ Lite

SISTEMI I ZGJEDHJES SË BATERISË EZSELECT™ LITE



MANUALI I PËRDORUESIT

EnerSys™
Power/Full Solutions™

www.enersys.com

CE UKCA

PËRMBAJTJA

Hyrje 3

Pjesët e sistemit

Pjesët individuale 4

Pjesët e këmbimit 5

Planifikimi / përcaktimi i punës

Përmbledhje e instalimit 6

Mjetet që nevojiten 6

Disponueshmëria e energjisë 6

Kutia e kontrollit 7

Pajisjet e monitorimit të karikuesve (CMD) 7

Kërkesat për kabllot e të dhënave 7

Shërbimi i instalimit dhe i vënies në punës 7

Lista e kontrollit para instalimit 7

Instalimi

Përmbledhje e instalimit 8

Kutia e kontrollit dhe instalimi i CMD 9

Lista e kontrollit e instalimit 10

Funksionimi

Zgjedhja e baterisë tjetër të disponueshme 11

Reagimi i sistemit 11

Treguesit LED vizualë të CMD 11

Përmbledhje e operacionit 12

HYRJE

EZSELECT™ Lite

Sistemi i zgjedhjes së baterisë EZSelect™ Lite optimizon performancën e dhomës së baterisë duke thjeshtuar përzgjedhjen e baterisë gjatë procedurës së ndërrimit të baterisë.

Një sistem i instaluar plotësisht përfshin një pajisje të monitorimit të karikuesve (CMD) të montuar në secilin karikues. CMD monitoron sjelljen e karikuesve dhe komunikon me kutinë e kontrollit. Kutia e kontrollit u jep përparësi të dhënave për t'u siguruar që bateria optimale të pozicionohet e para në radhë.

Sistemi i zgjedhjes së baterisë EZSelect™ Lite shfaq baterinë tjetër që duhet zgjedhur me një tregues LED blu të ndritshëm në një CMD. Nëse zgjidhet bateria e gabuar, aktivizohet një alarm. Kjo siguron që të gjitha bateritë dhe të gjithë karikuesit të bëjnë cikël në mënyrë uniforme, duke rritur kështu në maksimum jetëgjatësinë e tyre.

Për shërbime, kontaktoni përfaqësuesin tuaj të shitjeve ose telefononi:

EnerSys EMEA
EH Europe GmbH
Baarerstrasse 18
6300 Zug, Zvicër
Tel: +41 44 215 74 10

EnerSys World Headquarters
2366 Bernville Road
Reading, PA 19605, SHBA
Tel: +1-610-208-1991
+1-800-538-3627

EnerSys APAC
No. 85, Tuas Avenue 1
Singapore 639518
Tel: +65 6558 7333

www.enersys.com




Siguria juaj dhe siguria e të tjerëve është shumë e rëndësishme

⚠ KUJDES Mund të vriteni ose të lëndoheni rëndë nëse nuk ndiqni udhëzimet.

PJESËT E SISTEMIT

Pjesët individuale

Figura 1: Përmbledhje e pjesëve të sistemit të zgjedhjes së baterive EZSelect™ Lite



* Pjesë të ndryshme në dispozicion

PJESËT E SISTEMIT

Pjesët e këmbimit




EZS-CB6400EU-16

EZSelect™ Lite Kutia e kontrollit
(Maksimumi 50 karikues në një grup të vetëm)



EZS-143

Kabllo të dhënash 8m me një bashkues



EZS-SU600R

Pajisja e monitorimit të karikuesit (CMD)
(Kabllo të dhënash 2,1 m për çdo CMD të përfshirë)



EZS-228

Kabllo të dhënash CMD 2.1m

Përmbledhje e instalimit

Instalimi në vend mund të ndahet në tri faza:

1. **Kutia e kontrollit**
   a. Kutia e kontrollit

2. **Lidhjet me tela të CMD**
   a. Montimi në karikues
   b. Lidhja nga kutia e kontrollit në CMD të parë
   c. Lidhja nga CMD në CMD
   d. Emërtimi i vendeve të karikuesve/baterive


3. **Testimi përfundimtar**
   a. Testimi i funksionimit të kutisë së kontrollit
   b. Trajnimi i operatorit

Mjetet e nevojshme



Trapan dhe punto

Vida dhe upa të përshtatshme për montimin



Niveli



Kaçavidë



Prerës teli

Disponueshmëria e energjisë

Kërkesat e energjisë për pjesët e sistemit të zgjedhjes së baterisë EZSelect™ Lite :

Kutia e kontrollit
Hyrja e ushqimit elektrik: 100-240 VAC 50/60 Hz

Udhëzime të planifikimit të hapsirës që duhen marrë në konsideratë
Kordonët zgjatues mund të përdoren përkohësisht, megjithatë rekomandohet mbrojtje nga mbingarkesa për kutinë e kontrollit.

PLANIFIKIMI/PËRCAKTIMI I PUNËS

Kutia e kontrollit

Kutia e kontrollit duhet të vendoset në një hapësirë të mjaftueshme rreth CMD për të lidhur kabllot.

- Montojeni në një vend të dukshëm, pa pengesa.
- Mbajeni komponentin larg burimeve të ujit, si dushet e emergjencës dhe lavamanët.
- Përdorni kapëse të përshtatshme sipas nevojës për të mbështetur kutinë e kontrollit.

Pajisjet e monitorimit të karikuesve (CMD)

Nevojitet një CMD për çdo karikues. CMD është universal dhe mund të përdoret për çdo tension nga 12V në 80V.

Kërkesat për kabllon e të dhënave

Kabllot e të dhënave lidhin kutinë e kontrollit me CMD. Kur planifikoni një instalim, gjatësitë e kabllove duhet të mbahen në minimum. Me çdo kuti kontrolli duhet të keni:

- 2 kabllo 8 m
- 1 bashkues kabllosh

Një shembull i instalimit të kabllove është treguar në fig. 3.

Instalimi dhe vënia në punë


Sistemi i zgjedhjes së baterisë EZSelect™ Lite është projektuar që të mos kërkojë vënien në punë nga EnerSys®, por nëse kërkohet ndihmë, ajo ofrohet me kërkesë. Gjithashtu mund të gjenden online video lidhur me instalimin.

Lista e kontrollit para instalimit

Detyra	Statusi
A. Planifikoni vendndodhjen e kutisë së kontrollit	
• Korrenti për kutinë e kontrollit • Pranë karikuesve • Planifikoni për kalimin e kabllove të të dhënave në CMD e parë në çdo bus	☐
B. Mblidhni të gjitha mjetet dhe pajisjet e nevojshme	
• Shkallë dhe/ose ashensor gërshërë • Mjete me korrent - për montimin e kutisë së kontrollit, etj. • Vegla dore - prerës teli, kaçavidë • Kordonë zgjatues për energji të përkohshme • Upa për montimin e pjesëve sipas nevojës	☐

Instalimi

Figura 3: Shembull strukture e instalimit të sistemit të zgjedhjes së baterive EZSelect™ Lite



Instalimi

1




Montoni kutinë e kontrollit në mur duke përdorur katër vida/upa dhe një nivelues.

2




Futeni kabllon e parë të të dhënave CMD në një nga portat bus të disponueshme në kutinë e kontrollit.

3




Futni kabllon e të dhënave të CMD-së së parë në një fole në CMD-në e parë. Lidhni kabllon tjetër të të dhënave në një fole tjetër.

4




Montoni CMD-në me fasheta në mënyrë që të jetë e dukshme, e mbrojtur dhe e sigurt.

5




Lidheni CMD në seri derisa të lidhen të gjitha CMD në sbarë.
*** Maksimumi 50 CMD brenda një grupi të vetëm.**

6




Vendoseni konektorin midis kabllove pozitive dhe negative, dhe lidhni FlexiTaps me kabllot përkatëse.
***Sigurohuni që kunjat janë në qendër të kabllove dhe mos i përthyeni kunjat.**

7



Fiksojeni konektorin me stega.
Konfirmoni që drita LED portokalli ndizet në CMD me një bateri të lidhur.

8



Lidhni kontrolluesin me burimin e energjisë dhe konfirmoni që LED i gjelbër të ndizet.


LISTA E KONTROLLIT TË INSTALIMIT

Detyra	Statusi
1. Sigurohuni që të gjitha CMD-të të shfaqin një dritë të gjelbër konstante.	☐
2. Testoni sinjalizuesin për tinguj "të pasaktë" të zgjedhjes së baterisë nga kutia e kontrollit.	☐

Zgjedhja e baterisë tjetër të disponueshme

Mbajini të gjitha bateritë të lidhura derisa të zgjidhen, përveç nëse zgjidhen për mirëmbajtje. Sistemi dallon se kur një bateri është e lidhur me karikuesin, kur karikuesi fillon dhe përfundon, dhe për sa kohë bateria është e lidhur me karikuesin para se të zgjidhet.

Si të zgjidhni baterinë tjetër të disponueshme:



Pajisja e monitorimit të karikuesit (CMD)


LED blu konstant tregon që bateria ofrohet për t'u zgjedhur.

Reagimi i sistemit

Sinjalizuesi në kutinë e kontrollit bie me alarm kur zgjidhet një bateri e ndryshme nga ajo e treguar nga sistemi. Kur ndodh kjo, sistemi e konsideron si "zgjedhje të gabuar".

Treguesit vizualë LED të pajisjes së monitorimit të karikuesit (CMD)

Figura 4: Treguesit LED për CMD



(Solide) Lidhje e mirë
(Pulson) Lidhje e paqëndrueshme

Karikimi i baterisë


(Konstante) Bateria tjetër për t'u zgjedhur
(Pulson) Zgjedhje e gabuar e baterisë

Defekt në komunikim


** Nëse drita e kuqe e defekteve është e ndezur, ju lutemi ndërroni kabllon e të dhënave.*

PËRMBLEDHJE E OPERACIONIT

Figura 5: Shembull strukture e funksionimit të sistemit të zgjedhjes së baterisë EZSelect™ Lite




Zgjedhje e duhur



Zgjidhni baterinë e disponueshme me **LED blu konstant** në CMD.

* Për indikacionet e LED CMD, shihni Figurën 42.

Zgjedhje e gabuar



Nëse një bateri zgjidhet jashtë renditjes, **alarmi** do të tingëllojë nga sinjalizuesi i kutisë së kontrollit për të njoftuar operatorin.

Shtypni butonin e bardhë në kontrollues dhe kërkoni **dritën LED blu që pulson** në CMD për të gjetur se cila bateri po zgjidhet gabim.

www.enersys.com

© 2026 EnerSys. Të gjitha të drejtat të rezervuara. Të gjitha markat tregtare dhe logot janë pronë e EnerSys përveç Unistrut, CE, dhe UKCA e cila nuk është pronë e EnerSys. Objekt rishikimi pa njoftim paraprak. E&O.E.

GLOBAL-SQ-OM-EZSELECT-LITE-0626

EnerSys®
Power/Full Solutions